

**TË
PROMOVOSH
SHËNDETIN
QË NË
MOSHË TË
VOGËL**

BURIME PËR PRINDËRIT ME FËMIJË TË VEGJËL



PËRMBAJTJA

BROSHURË PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË VEGJËL	4
--	----------

TË KONCEPTOSH NJË FËMIJË	6
---------------------------------	----------

Qëndrat e shëndetit seksual – planifikimi familjar	7
--	---

Gjinekologët	8
--------------	---

Të tjera	8
----------	---

TË JESH I (E) SHOQËRUAR GJATË SHTATZËNISË E LINDJES	9
--	----------

Mamitë	10
--------	----

RHNe – Materniteti	11
--------------------	----

Qendra e lindjes	12
------------------	----

TË DISKUTOSH , TË TAKOHESH DHE TË GJESH KËSHILLA	13
---	-----------

Kryqi i Kuq Neuchâtel, Le Patio	14
---------------------------------	----

Shoqata e Prindërve të Rinj	15
-----------------------------	----

La Trottinette	15
----------------	----

La Courte-Échelle	16
-------------------	----

Info-Entraide	16
---------------	----

EPER – Hapësira për prindërit	17
-------------------------------	----

Kryqi i Kuq Neuchâtel, Femmes-Tische et Hommes-Tische	18
---	----

RECIF	19
-------	----

Të birësojmë & Mikpritja familjare	20
------------------------------------	----

TË JESH NËN KONTROLL PËR ÇËSHTJET E SHËNDETIT DHE TË ZHVILLIMIT	21
--	-----------

Mjekët pediatër	22
-----------------	----

Kryqi i Kuq Neuchâtel, Konsultimet infermierike të fëmijërisë së hershme	22
--	----

Të tjera	23
----------	----

TË MARRËSH NDIHMË PËR VËSHTIRËSITË EDUKATIVE , PSIKOLOGJIKE E SOCIALE BRËNDA FAMILJES	24
--	-----------

Zyra e mbrojtjes së fëmijës	25
-----------------------------	----

Fondacioni Carrefour, AEMO	26
----------------------------	----

Kryqi i Kuq Neuchâtel, Ndjekje psiko-edukative	27
--	----

Qendra Psikiatrike e Neuchâtel-it (CNP)	28
---	----

Qendra Psikiatrike e Neuchâtel-it, Këshilla për Çiftin dhe Familjen	29
---	----

Qendra Psikiatrike e Neuchâtel-it, Orientim për fëmijët	30
---	----

CSP Neuchâtel, Këshillim bashkëshortor dhe familjar	31
---	----

Psikologët, psikologët-psikoterapistë	32
---------------------------------------	----

Psikiatërit dhe pedopsikiatërit	33
---------------------------------	----

TË GJESH PËRKUJDESJE PËR FËMIJËN DHE NDIHMË PËR DETYRIMET E PËRDITSHME	34
Kryqi i Kuq Neuchâtel, Shërbimi Kujdestari për fëmijët në shtëpi	35
Kryqi i Kuq Neuchâtel, Baby-sitting	36
Pritje jashtë familjes	37
Zyra për strukturat e pritjes jashtë familjes dhe institucionet edukative të specializuara (OSAE)	37
GJENI MBËSHTETJE PËR TË PËRBALLUAR DËSHPËRIMIN	38
As'trame	39
Agapa Suisse-Romande	40
Notre petite parenthèse	40
NË RAST URGJENCE	41
Në rast urgjence, le 144	42
Linja telefonike pediatrike	42
NUMRA TË TJERË URGJENCE	42
ADRESA TË TJERA TË DOBISHME	43
E deleguara për rininë – SPAJ (Shërbimi për mbrojtjen e të rriturve dhe të rinjve)	44
Santé Psy (promovimi i shëndetit mendor)	44
L'Éducation donne de la force (Edukimi të jep forcë) – Neuchâtel	44

BROSHURË PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË VEGJËL

Në kantonin e Neuchâtel-it ka organizata të ndryshme që merren me promovimin e shëndetit të fëmijëve nga 0 deri në 4 vjeç. Ato ofrojnë shërbime të ndryshme dhe janë në dispozicion të prindërve ose të të rriturve që u referohen për pyetjet që lidhen me zhvillimin, shëndetin dhe edukimin e fëmijëve të tyre.

Departamenti i Shëndetit Publik e ka realizuar këtë broshurë prezantimi për t'i ndihmuar prindërit të mësojnë më shumë rreth këtyre burimeve dhe të kenë një qasje më të lehtë me to.

Prandaj, do të ndiheshim mirë nëse gjeni kohën ta lexoni këtë broshurë, duke shpresuar se do të jetë e dobishme për ju! Të gjitha përfitimet dhe shërbimet e paraqitura në këtë broshurë janë të mundshme për të gjithë. Megjithatë, ka edhe shërbime të tjera, tek të cilat mund të drejtoheni nëpërmjet orientimit të mjekut tuaj ose nëpërmjet zyrës së mbrojtjes së fëmijëve.

- Broshurën mund ta gjeni në frëngjisht dhe në disa gjuhë të tjera. Mund të porositet ose të shkarkohet në version elektronik në faqen e internetit <https://www.ne.ch/autorites/DFS/SCSP/prevention/Pages/Petite-enfance.aspx>
- Departamenti i Shëndetit Publik nuk është përgjegjës për aktivitetet e ofruara nga organizatat e paraqitura në këtë broshurë. Për këtë arsye, shërbimet e tyre nuk mund ta angazhojnë departamentin e shëndetit publik.

TË KONCEPTOSH NJË FËMIJË

QËNDRAT E SHËNDETIT SEKSUAL – PLANIFIKIMI FAMILJAR

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam pyetje në lidhje me seksualitetin
- Kërkoj një kontracetim
- Kam nevojë për ndihmë urgjente në lidhje me jetën seksuale
- Kërkoj të shoqërohem në projektin tim të shtatzënisë

Qendrat e shëndetit seksual ofrojnë informacion, udhëzime dhe mbështetje për të gjitha çështjet që lidhen me shëndetin seksual. Ato janë të hapura për të gjithë, individualisht, në çift ose në grup. Bashkëbisedimet janë konfidenciale dhe falas.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Seksualiteti
- Kontracetimi
- Shtatzënia e planifikuar ose e paplanifikuar
- Infeksionet seksualisht të transmetueshme
- Orientimi seksual
- Dhuna
- Fertiliteti

- Konsulencë falas (disa shërbime janë me pagesë)

NË NEUCHÂTEL

Rue Saint-Maurice 4

- 032 717 74 35

- www.sante-sexuelle-ne.ch

NË LA CHAUX-DE-FONDS

Rue de la Serre 14

- 032 967 61 87

- www.chaux-de-fonds.ch/sante-sexuelle

GJINEKOLOGËT

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam shtatzënë
- Kam nevojë për një ndjekje mjekësore, për këshilla dhe mbështetje në lidhje me shtatzëninë ose lindjen e fëmijës
- Kam nevojë të orientohej për të gjetur një vënd për të lindur
- Kërkoj këshilla në lidhje me çdo problem gjinekologjik

Gjinekologët ndjekin gratë e të gjitha moshave për çdo problem që lidhet me shëndetin e tyre seksual në plan të gjërë. Këta profesionistë u përgjigjen pyetjeve në lidhje me seksualitetin, riprodhimin, ekzaminimin dhe ofrojnë kujdesin e nevojshëm gjatë shtatzënisë dhe në muajt në vijim. Gjinekologët janë gjithashtu të autorizuar t'u përshkruajnë pacientëve dhe partnerëve të tyre një takim në njësinë e infertilitetit (sterilitetit) të RHNe* (UFN**) nëse ata nuk janë në gjendje të kenë fëmijë.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Shqyrtimi
- Kontrolli mjekësor
- Shtatzënitë
- Kontraceptimi
- Çrregullimet menstruale
- Menopauza
- Steriliteti

LISTA E GJINEKOLOGËVE TË KANTONIT TË NEUCHÂTEL-IT

- <http://www.snm.ch/index.php/component/comprofiler/userslist/42-liste-gynecologie-obstetrique>

SHOQATA ZVICERANE E GJINEKOLOGJISË DHE OBSTETRIKËS

- 031 313 88 55
- www.sggg.ch/fr/

TË TJERA

Ka edhe shërbime të tjera që lidhen me temën e konceptimit të një fëmije, veçanërisht Njësia e Fertilitetit të Rrjetit Spitalor të Neuchâtel-it (RHNe) e cila u drejtohet çifteve që dëshirojnë të gjejnë përgjigje për pyetjet në lidhje me sterilitetin. Për këtë duhet të flisni me gjinekologun tuaj.

* Rrjeti Spitalor i Neuchâtel-it

** Njësia e Fertilitetit, Neuchâtel

TË JESH I (E) SHOQËRUAR GJATË SHTATZËNISË E LINDJES

MAMITË

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam shtatzënë
- Kam nevojë të përgatitem për lindjen e fëmijës tim
- Kam lindur dhe dëshiroj të përfitoj një përkujdesje në shtëpi për foshnjën time dhe për mua
- Kam pyetje në lidhje me ushqyerjen me qumësht gjiri
- Kam nevojë të flas me një profesionist të kujdesit mjekësor

Mamitë ofrojnë mbështetje, këshilla dhe kujdes për gratë gjatë shtatzënisë, lindjes dhe gjatë gjithë periudhës pas lindjes. Këto profesioniste ofrojnë konsultime për shtatzëninë, ndjekje të shtatzënisë me rrezik të lartë dhe përgatitje për lindje. Shoqërimi i prindërve vazhdon edhe pas lindjes së fëmijës dhe ka të bëjë me mbështetjen për rolin prindëror si dhe këshillat për përshtatjen e nënës, babait, vëllezërve dhe motrave që presin të porsalindurin. Mamitë ofrojnë mbështetje për ushqyerjen me gji, si dhe kujdes mjekësor dhe higjienik. Po ashtu, ofrojnë kurse (masazh, veshje për fëmijën, etj.) Mamitë e praktikojnë lindjen në spital, në shtëpi ose në qendrat e lindjes.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Shtatzënia
- Lindja
- Konsultimet e shtatzënisë
- Shtatzënitë me rrezik të lartë
- Përgatitja e lindjes
- Lindja e fëmijës
- Pas lindjes
- Të ushqyerit me gji
- Mbështetje prindërve

- Shumica e shërbimeve rimbursohet nga LAMa1

NE-SENS, SHOQATA E MAMIVE TË NEUCHÂTEL-IT PËR VIZITA SHTËPIAKE

- 079 280 48 28
- www.ne-sens.ch

FÉDÉRATION SUISSE DES SAGES-FEMMES (FEDERATA ZVICERANE E MAMIVE)

- 031 332 63 40
- info@sage-femme.ch
- www.sage-femme.ch

RHNE – MATERNITETI

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam shtatzënë
- Kam nevojë për këshilla dhe mbështetje në lidhje me shtatzëninë ose lindjen
- Po kërkoj një vënd për të lindur
- Kam nevojë të flas me një profesionist të besuar për foshnjën time

Gjatë shtatzënisë, ekipi i maternitetit ofron konsultime shtatzënie, seanca përgatitore për lindjen si dhe konsulta për akupunkturë dhe hipnozë. Takimi me një mami bën të mundur planifikimin e lindjes. Përveç kësaj, mamitë këshilltare ofrojnë mbështetje dhe këshilla në rast të një situatë të vështirë familjare. Çdo graje i ofrohet një ndjekje individuale, e cila përfshin edhe metoda alternative - kjo mbështetje vazhdon edhe pas lindjes.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Shtatzënia
- Lindja
- Ndjekja e personalizuar
- Akupunktura
- Hipnoza
- Masazhe
- Lindja në vaskën me ujë
- Kurse

RÉSEAU HOSPITALIER NEUCHÂTELOIS (RRJETI I SPITALEVE TË NEUCHÂTEL-IT)

Pourtalès, Maladière 45

2000 Neuchâtel

→ 032 713 33 07

→ <https://www.rhne.ch/maternite>

QËNDRA E LINDJES

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam shtatzënë
- - Kam nevojë për këshilla dhe mbështetje në lidhje me shtatzëninë ose lindjen
- Kam nevojë të flas me një profesionist të besuar për foshnjën time

Qendrat e lindjes janë një alternativë për maternitetin, një kornizë e tillë që lejon planifikimin e një lindjeje fiziologjike dhe shumë të individualizuar. Çifti do të ndiqet nga të njëjtat mami që e kanë shoqëruar gjatë shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes, të cilat ofrojnë seanca përgatitore për lindjen, metodën përgatitore të haptonomisë, akupunkturën si dhe jogën. Këtu mund të pranohen vetëm gratë, lindja e të cilave nuk kërkon një ndjekje mjekësore.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Shtatzënia
- Lindja
- Ndjekja e personalizuar
- Kurse
- Joga
- Akupunktura
- Masazhe
- Refleksologjia
- Haptonomia (teknikë e komunikimit me fetusin nëpërmjet prekjës nga muri i barkut të nënës).

MAISON DE NAISSANCE TILIA (QËNDRA E LINDJES TILIA)

Chemin des Valangines 9
2000 Neuchâtel

032 724 12 23

- info@tilia-naissance.ch
- www.tilia-naissance.ch

TË DISKUTOSH, TË TAKOHESH DHE TË GJESH KËSHILLA

KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL, LE PATIO

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është nga 0 deri në 4 vjeç
- Kam dëshirë të flas me prindërit e tjerë
- Kam dëshirë të ndaj përvojën ose shqetësimet e mia

Qendra Le Patio e Kryqit të Kuq të Neuchâtel-it është një hapësirë ku prindërit e fëmijëve të moshës nga 0 deri në 4 vjeç mund të vijnë dhe të shkëmbejnë përvojat, pyetjet dhe frikën e tyre në lidhje me edukimin e fëmijëve të tyre. Në dispozicionin tuaj është një program (me regjistrim paraprak) rreth temave të ndryshme që lidhen me zhvillimin e fëmijës dhe rolin e prindërit.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Diskutime
- Shkëmbim eksperiencash
- Këshilla
- Ushqimi
- Edukimi
- Familja
- Zhvillimi

- Free service
- 032 886 88 60
- puericulture@croix-rouge-ne.ch
- www.croix-rouge-ne.ch/services/le-patio/

SHOQATA E PRINDËRVE TË RINJ

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam një prind i ri/e re ose një prind i ri /e re së shpejti (prindër nën 25 vjeç)
- Kam dëshirë të flas me prindër të tjerë të moshës sime
- Kam nevojë për këshilla dhe udhëzime
- Kam nevojë për mbështetje që të nis ose të pasuroj përvojën edhe pse jam prind

Association JeunesParents (Shoqata e Prindërve të Rinj) ofron mbështetje dhe udhëzime për prindërit e ardhshëm dhe prindërit e rinj. Ajo mundëson takime dhe shkëmbime midis bashkëmohatarëve duke ofruar mbështetje dhe këshilla të personalizuar, si dhe shoqërim për të filluar ose vazhduar formimin e tyre, pavarësisht shtatzënisë ose të qenit prind.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Shtatzënia
- Të jesh nënë e re
- Të jesh baba i ri
- Aborti
- Mbështetje për trajnim
- Pasiguria
- Shkëmbimi i përvojës
- Ndihma e ndërsjellë

ASSOCIATION JEUNESPARENTS (SHOQATA E PRINDËRVE TË RINJ)

- 077 474 73 37
- contact@jeunesparents.ch
- jeunesparents.ch

LA TROTTINETTE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është nga 0 deri në 4 vjeç
- Kërkoj një strukturë për të dëgjuar, shkëmbyer e luajtur
- Kam dëshirë të kaloj kohë me fëmijën tim

Shoqata La Trottinette është një vend mikpritjeje për fëmijët nga 0 deri në 4 vjeç, të cilët shoqërohen nga një i rritur (prindër, gjyshër, kumbar, kumbare, etj.). Atje mund të shkohet në mënyrë anonime dhe pa regjistrim për të gjetur një çast qetësie, për të heshtur ose për të folur, për të luajtur me fëmijë të tjerë dhe për të takuar të rritur të tjerë si dhe profesionistë.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Mirë se vini prindër e fëmijë
- Shoqërim
- Dëgjim
- Shkëmbim

ASSOCIATION LA TROTTINETTE (SHOQATA LA TROTTINETTE)

- Rue de la Serre 24
- 2300 La Chaux-de-Fonds
- 032 914 52 60
- info@association-la-trottinette.ch
- <http://www.association-la-trottinette.ch>

LA COURTE-ÉCHELLE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është nga 0 deri në 5 vjeç
- Kërkoj një strukturë dëgjimi, shkëmbimi dhe loje
- Kam dëshirë të kaloj kohë me fëmijën tim

Shoqata La Courte-Échelle është një vend mikpritjeje për fëmijët nga 0 deri në përvjetorin e tyre të 5-të, të cilët shoqërohen nga një i rritur. Atje fëmija mund të luajë, të lëvizë, të flasë, të eksplorojë, të zbulojë jetën në shoqëri, ndërsa i rrituri që e shoqëron mund të shkëmbejë, të pyesë veten e të tjerët, të luajë me fëmijën e tij dhe të takojë prindër të tjerë si dhe profesionistë.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Mirë se vini prindër e fëmijë
- Shoqërim
- Dëgjim
- Shkëmbim

LA COURTE-ÉCHELLE

Rue des Fausses-Brayes 3
2000 Neuchâtel

- 032 724 45 15
- info@lacourteechelle.ch
- www.lacourteechelle.ch

INFO-ENTRAIDE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Unë kërkoj një grup ku të mbështetem
- Kam dëshirë të takoj njerëz që kanë të njëjtat shqetësime si unë
- Kam nevojë të ndihem i/e mbështetur në tema që më prekin

Info-Entraide (informacion dhe ndihmë reciproke) është pika e kontaktit dhe e koordinimit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën e ndërsjellë e të vetë-menaxhuar në Kantonin e Neuchâtel-it. Kjo ndihmë e ndërsjellë bashkon njerëz që përjetojnë situata të njëjta. Ajo merr kryesisht formën e grupeve që bashkohen me synimin për të ndihmuar njëri-tjetrin, për të diskutuar zgjidhje dhe për të mbledhur informacion. Info-Entraide përfshin të gjitha grupet që ekzistojnë në lidhje me tema të ndryshme shëndetësore, psikologjike ose sociale, disa prej të cilave kanë të bëjnë me prindërit e fëmijëve të vegjël: disa nga shembujt janë lindjet e parakohshme, familjet me një prind të vetëm, prindërit e fëmijëve alergjikë, sëmundjet e rralla ose konsumimi.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Ndihma e ndërsjellë
- Shkëmbimi
- Trajnimi
- Rrjetëzimi
- Grupet mbështetëse të diskutimit
- Mbështetja

INFO-ENTRAIDE SUISSE NEUCHÂTEL OFFICE

- 032 724 06 00
- 076 549 26 06
- info@infoentraideneuchatel.ch
- www.infoentraideneuchatel.ch

EPER – HAPËSIRA PËR PRINDËRIT

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kërkoj dëgjim dhe mbështetje në procedurat e mia të përditshme administrative
- Kërkoj të bëj aktivitete me fëmijët e mi
- Dëshiroj të gjej një vend për takime dhe shkëmbime

L'Espace Parents (Hapësira për prindërit) është një vend dëgjimi, këshillimi dhe udhëzimi për prindërit. Ajo synon të rrisë autonominë dhe vetëbesimin, të forcojë aftësitë prindërore dhe sociale dhe të promovojë integrimin. Këtu propozohen tre fusha veprimi: dëgjimi psikosocial dhe mbështetja administrative, aktivitetet prindër-fëmijë me seminare informuese për prindërit dhe së fundmi, aktivitete që synojnë forcimin e aftësive bazë në fushën dixhitale

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Dëgjim dhe këshilla
- Mbështetje administrative
- Praktikum i frëngjishtes
- Takime dhe shkëmbime
- Aktivitete prind-fëmijë
- Informacion për prindërit
- Shkëmbim dhe informacion për baballarët
- Aftësi informatike

- Shërbim falas

EPER, ESPACE PARENTS

Ch. Des Valangines 97

2000 Neuchâtel

- sophie.sarr@eper.ch

- 078 936 44 78

- <https://www.eper.ch/project-explorer/espace-parents>

KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL, FEMMES-TISCHE ET HOMMES-TISCHE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam mbërritur kohët e fundit në kantonin e Neuchâtel-it ose ndihem i/e izoluar
- Do të dëshiroja të flisja për edukimin ose shëndetin e fëmijës tim
- Kërkoj këshilla nga nënat ose baballarët e tjerë

Tryezat e rrumbullakëta të Women-Tische dhe Men-Tische mbledhin së bashku 8 deri në 10 gra ose burra që dëshirojnë të diskutojnë në gjuhën e tyre amtare dhe të thellojnë së bashku, njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi tema të rëndësishme për shëndetin e tyre dhe të familjes, për zhvillimin e mirë dhe edukimin e fëmijëve të tyre, për integrimin e tyre, si dhe për jetën e përditshme.

Këto takime janë, po ashtu, një mundësi për të krijuar kontakte, për t'u dëgjuar dhe për të pasuruar reciprokisht përvojën e pjesëmarrësve të tjerë. Nëse është e nevojshme, Kryqi i Kuq mund të ofrojë edhe ndërhyrje në shtëpi.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Kontakt me nënat e tjera dhe me baballarët e tjerë
- Njohuri për ofertat e fëmijëve dhe prindërve
- Shkëmbim
- Dëgjim
- Lidhje sociale midis grave ose midis burave

- Shërbim falas

FEMMES-TISCHE, CROIX-ROUGE NEUCHÂTEL HOMMES-TISCHE, CROIX-ROUGE NEUCHÂTEL

- 032 886 88 60
- contact@croix-rouge-ne.ch
- www.croix-rouge-ne.ch/services/femmes-tische/
- www.croix-rouge-ne.ch/services/hommes-tische/

RECIF

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam një grua
- Po kërkoj të fitoj njohuri praktike për të ndihmuar integrimin tim
- Kam dëshirë të krijoj kontakte miqësore dhe sociale

RECIF (Qendra e trajnimit, takimeve dhe shkëmbimeve për gratë emigrante dhe zvicerane) synon mbështetjen dhe lehtësimin e integrimin të grave emigrante dhe fëmijëve të tyre, si dhe promovimin e takimeve dhe shkëmbimeve midis grave me prejardhje të ndryshme. Ajo ka tre fusha veprimi: aktivitete trajnuese, aktivitete për fëmijë si dhe një hapësirë për argëtim, takime dhe shkëmbime. Për të mundësuar pjesëmarrjen e grave, RECIF ofron një sistem kujdesi pa pagesë për fëmijët, gjatë kohës kur zhvillohen kurset. Kjo u mundëson fëmijëve të moshës 4 muaj deri në 4 vjeç të shoqërohen dhe të familjarizohen me gjuhën frënge.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Trajnim
- Kujdesi për fëmijët gjatë mësimit
- Gjuha frënge
- Socializimi
- Takime dhe shkëmbime

- Kopsht për fëmijët falas

NË NEUCHÂTEL:

Rue de la Cassarde 22

- 032 730 33 50
- 2000@recifNE.ch
- www.recifne.ch

NË LA CHAUX-DE-FONDS:

Rue du Doubs 32

- 032 968 62 42
- 2300@recifNE.ch
- www.recifne.ch

TË BIRËSOJMË & MIKPREDITJA FAMILJARE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Ne do të birësojmë një fëmijë
- Ne dëshirojmë të ofrojmë mirëpritje në gjirin e familjes
- Ndjej nevojën të njoh çështjet e birësimit dhe të pranimit në familje

Shoqata Adoptons-nous & Accueil familial ofron një vend dëgjimi dhe mbështetjeje për prindërit para dhe pas birësimit. Ajo shpërndan burime dhe njohuri rreth kësaj teme, duke organizuar seminare, grupe diskutimi, konferenca dhe trajnime. Kjo qëndër e Birësimit dhe e Pritjes familjare në Peseux ofron konsultime nga një ekip multidisiplinar.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Birësimi
- Mikpritja në gjirin e familjes
- Afrimi dhe traumat e hershme
- Normaliteti adoptues
- Pasiguria afektive
- Dëgjimi
- Mbështetja
- Trajnime
- Shkëmbime

CENTRE ADOPTONS-NOUS & ACCUEIL FAMILIAL (QËNDRA E BIRËSIMIT DHE E PRITJES FAMILJARE)

Route de Neuchâtel 39

Peseux

- 076 451 99 15
- info.centreaa@gmail.com
- www.adoptons-nous.ch

TË JESH NËN KONTROLL PËR ÇËSHTJET E SHËNDETIT DHE TË ZHVILLIMIT

MJEKËT PEDIATËR

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im nuk ka ende një profesionist që të kujdeset për shëndetin e tij
- Fëmija im është i sëmurë
- Nuk di se kë të kontaktoj për një problem që lidhet me fëmijën tim

Pediatri është referenca profesionale për shëndetin e një fëmije. Ai e ndjek gjatë gjithë kohës dhe me të mund të krijohet një marrëdhënie besimi. Nëse është e nevojshme, mos hezitoni t'i bëni pyetje.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Shëndeti
- Zhvillimi
- Sëmundja
- Lëndimi
- Ndjekja afatgjatë

LISTA E MJEKËVE PEDIATËR TË KANTONIT TË NEUCHÂTEL-IT

- <http://www.snm.ch/index.php/profil/user-slist/7-liste-des-pediatres>

KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL, KONSULTIMET INFERMIERIKE TË FËMIJËRISË SË HERSHME

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Unë kam nevojë për këshilla që të kujdesem për fëmijën tim
- Kam pyetje në lidhje me mënyrën e ushqyerjes dhe zhvillimin e fëmijës tim
- Do të dëshiroja një ndjekje profesionale për fëmijën tim

Konsultimet infermierike të fëmijërisë së hershme janë në dispozicion të familjeve për t'i mbështetur ato gjatë 4 viteve të para të jetës së fëmijës së tyre. Prindëru të rinj u ofrohen këshilla dhe mbështetje me tema të tilla si zhvillimi, të ushqyerit e madje edhe gjumi i fëmijës. Gjatë konsultimeve me infermierët, prindërit mund të gjejnë gjithashtu edhe ndihmë të përshtatur për çdo situatë familjare si dhe informacione mbi masat parandaluese mjekësore.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Kujdesi
- Të ushqyerit me gji
- Ushqimi
- Zhvillimi psikomotor
- Gjumi
- Të qarat
- Jeta në familje

- Shërbim falas
 - 032 886 88 60
 - puericulture@croix-rouge-ne.ch
 - www.croix-rouge-ne.ch/services/consultations-infirmieres-petite-enfance
- Këshilla nëpërmjet telefonit, e-mailit ose konsultime në një qendër (adresat janë të disponueshme në faqen e internetit të Kryqit të Kuq Neuchâtel).

TË TJERA

Në kanton ka shërbime të tjera, tek të cilat mund të kërkohet ndihmë për çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijës suaj. Këtu mund të përmëndim veçanërisht Qendrën e Psikomotorikës dhe Shërbimit edukativ shëtitës; pediatri juaj mund t'ju referojë atje nëse e sheh të nevojshme.

TË MARRËSH NDIHMË PËR VËSHTIRËSITË EDUKATIVE, PSIKOLOGJIKE E SOCIALE BRËNDA FAMILJES

ZYRA E MBROJTJES SË FËMIJËS

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam vështirësi edukative ose sociale me fëmijën tim
- Fëmija im vuan nga marrëdhënie të vështira familjare
- Kam pyetje në lidhje me abuzimin (dhunën, përbuzjen ose poshtërimin)

Zyra e mbrojtjes së fëmijës ofron mbështetje për familjet që hasin vështirësi edukative ose sociale, në formën e ndjekjes vullnetare ose të mandatit. Ajo është gjithashtu qendra kantonale e konsultimit për të gjitha çështjet e abuzimit të fëmijëve. Kjo zyrë mund t'i ridrejtojë prindërit drejt shërbimeve kompetente edukative në varësi të situatës specifike të familjes. Atje mund të merret informacion pa pasur nevojë të hapet një dosje.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Vështirësitë edukative
- Vështirësitë sociale
- Marrëdhëniet e vështira familjare
- Birësimi dhe identiteti
- Problemet e zhvillimit
- Sëmundjet mendore ose fizike
- Vendosi
- Keqtrajtimi

- Shërbim falas

<https://www.ne.ch/autorites/DEF/SPAJ/protection-enfant/Pages/accueil.aspx>

LITTORAL EST – VAL-DE-RUZ

Faubourg de l'Hôpital 36

2000 Neuchâtel

- 032 889 66 40

→ opene@ne.ch

LITTORAL OUEST – VAL-DE-TRAVERS

Quai Philippe Godet 5

2000 Neuchâtel

- 032 889 86 65

→ opeb@ne.ch

MONTAGNES NEUCHÂTELOISES

Rue du Rocher 7

2300 La Chaux-de-Fonds

- 032 889 66 45

→ opec@ne.ch

- <https://bit.ly/protection-enfant>

FONDACIONI CARREFOUR, AEMO

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Ndeshem me vështirësi edukative, relacionale ose sociale me fëmijën tim
- Kërkoj të reflektoj për nevojat e fëmijës tim dhe të gjej mënyra si t'i përmbush ato
- Fëmija im ka nevojë të shoqërohet dhe të mbështetet në zhvillimin e tij
- Fëmija im është nga 0 deri në 18 vjeç

AEMO u adresohet të gjithë prindërve dhe fëmijëve të tyre, të moshës nga 0 deri në 18 vjeç, të cilët hasin vështirësi edukative, relacionale dhe/ose sociale dhe që kanë nevojë për mbështetje praktike për të ushtruar rolin e prindërit në aktivitetet e përditshme. AEMO mbështet prindërit në identifikimin dhe kuptimin e nevojave të fëmijës për të favorizuar zhvillimin e tyre fizik, psikik, emocional dhe social duke forcuar kompetencat edukative të prindërve dhe duke ruajtur lidhjen prind-fëmijë. Ajo mundëson takime të rregullta në shtëpi, jashtë ose në AEMO për një periudhë të caktuar.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Vështirësitë edukative
- Vështirësitë familjare
- Vështirësitë sociale dhe relacionale
- Mbështetje ndaj prindërve
- Shoqërim edukativ ambulator
- Hapësirë për të biseduar për prindërit dhe fëmijën

- Shërbim i ofruar për popullatën

AEMO, FONDATION CARREFOUR

AEMO LITTORAL, VAL-DE-RUZ AND VAL-DE-TRAVERS

Rue de la Fontaine 4
2034 Peseux
→ 032 886 89 11
→ aemo@ne.ch

AEMO LA CHAUX-DE-FONDS, LE LOCLE, VALLÉES DE LA SAGNE AND LES PONTS-DE-MARTEL

Léopold-Robert 51
2300 La Chaux-de-Fonds
→ 032 886 88 99
→ aemo.cdf@ne.ch

- http://www.fondation-carrefour.net/?page_id=19

KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL, NDJEKJE PSIKO-EDUKATIVE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Ndeshem me vështirësi në edukimin e fëmijës tim
- Familja ime po kalon një krizë prindërore
- Kam nevojë të forcoj aftësitë e mia prindërore dhe të rivendos lidhjen me fëmijën tim
- Jam në një situatë migrimi dhe kam vështirësi integrimi

Ndjekja psiko-edukative ofron mbështetje për fëmijët nga 0 deri në 18 vjeç (e lart) si dhe për familjarët e tyre. Me kërkesë të prindërve ose të një profesionisti, në shtëpitë e tyre vjen në ndihmë një ekip edukatorësh dhe psikologësh. Ky shërbim u ofrohet familjeve që hasin vështirësi në integrim, në adaptimin e tyre kulturor, në familje, në edukim, në shkollë, u ofrohet atyre që kanë vështirësi psikologjike, sociale, komunikative, emocionale, relacionale apo në lidhje me dhunën. Punonjësit e ndërhyrjes psiko-edukative punojnë me të gjithë anëtarët e familjes për të kuptuar vështirësitë e tyre dhe burimet e këtyre vështirësive, në mënyrë që të kërkojnë së bashku mënyrat e rehabilitimit dhe mjetet për të mundësuar funksionimin e duhur dhe një klimë të këndshme familjare.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Integrimi
- Adaptimi kulturor
- Edukimi
- Vështirësitë në shkollë
- Vështirësitë psikike
- Vështirësitë sociale
- Komunikimi
- Emocionet
- Marrëdhëniet
- Dhuna

- Shërbim falas
- 032 886 88 60
- spe@croix-rouge-ne.ch
- <https://croix-rouge-ne.ch/services/suivi-psycho-educatif/>

QËNDRA PSIKIATRIKE E NEUCHÂTEL-IT (CNP)

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam nevojë për ndihmë që fëmija im dhe/ose unë të ndihemi më mirë
- Fëmija im shfaq shenja të vuajtjes psikike

Qendra Psikiatrike e Neuchâtel-it është qendra referuese kantonale për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin mendor. Ashtu siç mund t'i drejtohem mjekut apo pediatrit, në rast se kemi një problem shëndetësor fizik, pa patur hezitim dhe krejt natyrshëm, në të njëjtën mënyrë dhe po aq natyrshëm mund të kërkojmë ndihmë edhe për mirëqenien mendore. Mos hezitoni të kërkonin ndihmë kur është e nevojshme.

Departamenti i psikiatrisë për fëmijë dhe adoleshentë i CNP-së u adresohet më konkretisht fëmijëve të moshës 0 deri në 18 vjeç dhe familjarëve të tyre. Ky departament ofron një gamë të gjerë kujdesi dhe merr në ngarkim fëmijët që vuajnë nga vështirësi psikike. Konsultat mjekësore-psikologjike destinohen po ashtu edhe për fëmijët e moshës 0 deri në 6 vjeç dhe për familjet e tyre, ashtu si edhe për gratë shtatzëna në vështirësi dhe bashkëshortët e tyre. CNP bën vlerësimin dhe merr përsipër në mënyrë specifike fëmijën, duke ofruar një mbështetje edhe për prindërit.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Të ndihesh keq
- Problemet psikike
- Mbështetja specifike sipas nevojës
- Mbështetja për prindërit
- Konsultimet ambulatorë
- Bilanci neuropsikologjik

- Shërbimet e Qendrës Psikiatrike të Neuchâtel-it merren përsipër nga LAMaL.

QËNDRA PSIKIATRIKE E NEUCHÂTEL-IT – FËMIJËRIA DHE ADOLESHENCA

- <https://www.cnp.ch/soins-et-prestations/enfants-et-adolescents/>

CENTRE DE PSYCHIATRIE COMMUNAUTAIRE DU LITTORAL

Rue de Vieux-Châtel 18-20
2000 Neuchâtel
→ 032 755 23 11
→ ea-ln.ca@cnp.ch

CENTRE DE PSYCHIATRIE COMMUNAUTAIRE DE MONTAGNES

Rue Jardinière 175a,
2300 La Chaux-de-Fonds
→ 032 755 23 51
→ ea-mn.ca@cnp.ch

QËNDRA PSIKIATRIKE E NEUCHÂTEL-IT, KËSHILLA PËR ÇIFTIN DHE FAMILJEN

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam nevojë për ndihmë për të vlerësuar marrëdhënien e çiftit brënda familjes time
- Më duhet t'i jap kuptim marrëdhënies së çiftit ose familjes sime

Konsultimi nga Couples et Familles (Çiftet dhe Familja) ofron bashkëbisedime në çift dhe në familje për të ndihmuar bërjen e një bilanci dhe për t'i dhënë ndihmë marrëdhënies së çiftit dhe asaj të familjes me rolin e një burimi ripërtëritës. Ndodh ndonjëherë që është e nevojshme të rifreskohet marrëdhënia e çiftit apo e familjes, e për këtë nuk duhet hezituuar të kërkohet ndihmë. Këto konsultime ofrojnë, në rast nevoje, edhe konsulta në lidhje me dhunën brënda familjes.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Çiftet
- Familjet
- Të ndihesh keq
- Terapia në çift
- Terapia në familje

CENTRE NEUCHÂTELOIS DE PSYCHIATRIE

Préflagier, bâtiment B

2074 Marin-Épagnier

→ 032 755 14 68

→ cf-in.consultation@cnp.ch

CENTRE DE PSYCHIATRIE COMMUNAUTAIRE DES MONTAGNES

Rue Jardinière 157a,

2300 La Chaux-de-Fonds

→ 032 755 24 51

→ cf-in.consultation@cnp.ch

QËNDRA PSIKIATRIKE E NEUCHÂTEL-IT, ORIENTIM PËR FËMIJËT

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është nga 0 deri në 6 vjeç
- Më duhet të marr kontakt me profesionistë si prind ose si prind i ardhshëm
- Kam nevojë për këshilla në lidhje me zhvillimin emocional ose social të fëmijës tim

Njësia e orientimit të fëmijëve është një strukturë ambulatorie për fëmijët e vegjël, prindërit e tyre, ata që ndodhen përreth tyre si dhe për prindërit e ardhshëm. Qëllimi i saj është të përmirësojë përshtatjen e fëmijëve me mjedisin e tyre, duke u fokusuar veçanërisht në marrëdhëniet e tyre afektive dhe sociale. Kjo njësi merret me shqyrtimin, vlerësimet dhe menaxhimin e vështirësive të fëmijëve dhe prindërve të tyre: kjo mund të ketë të bëjë me çrregullimet gjuhësore, me vëmendjen, me raportin, me sjelljen ose vështirësitë që kanë të bëjnë me të qenit prind. Profesionistët e kësaj njësie e përshtatin punën sipas situatës së çdo familjeje.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Marrja në ngarkim e kujdesit ambulator
- Bilancet
- Mbështetja
- Zhvillimi psikoafektiv
- Shtatzënia
- Pas lindjes
- Të qenit prind
- Çrregullimet gjuhësore
- Çrregullimet e sjelljes
- Çrregullimet e lidhjes afektive
- Ankthi
- Fobitë
- Potenciali i lartë (HP)

- Shërbimet mbuloohen plotësisht nga LA-Mal.

UNITÉ DE GUIDANCE INFANTILE, CNP (NJËSIA E ORIENTIMIT PËR FËMIJËT)

- <https://www.cnp.ch/soins-et-prestations/enfants-et-adolescents/guidance-infantile/>

LE LOCLE ET LA CHAUX-DE-FONDS

Consultation ambulatoire des Montagnes

- 032 755 23 51

NEUCHÂTEL ET COUVET

Consultation ambulatoire du Littoral

- 032 755 23 11

CSP NEUCHÂTEL, KËSHILLIM BASHKËSHORTOR DHE FAMILJAR

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kërkoj këshilla për jetën time bashkëshortore ose të familjes
- Kam nevojë për ndihmë për të gjetur një ekuilibër brenda çiftit ose familjes sime

(CSP) Qendra Social Protestante e Neuchâtel-it është e hapur për të gjithë, për të ofruar këshillim për bashkëshortët dhe familjet e tyre. Ajo ju mundëson të flisni dhe të kërkonit këshilla nga profesionistë, për të gjetur zgjidhje për problemet e hasura, qofshin të vështirësisë për dialog, për mbrritjen e një fëmije, për jetën seksuale apo për ndonjë problem tjetër. Konsultimet, rreptësisht konfidenciale, janë të mundshme në çift ose vetëm, duke patur në dispozicion edhe një linjë telefonike.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Komunikimi
- Jeta intime e çiftit
- Jeta seksuale
- Mbrritja e një fëmije
- Jeta e përditshme
- Familja e rindërtuar
- Ndarja
- Dhuna verbale dhe psikologjike

CSP NEUCHÂTEL

- 032 886 91 00
- csp.neuchatel@ne.ch
- www.csp.ch/neuchatel/services/questions-de-couple

LINJA TELEFONIKE

- 0840 420 420
- www.permanencecouplefamille.ch

PSIKOLOGËT, PSIKOLOGËT-PSIKOTERAPISTË

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Ndonjëherë ndihem i/e dërrmuar që nga lindja e fëmijës tim
- Fëmija im vuan nga probleme mendore
- Familja jonë po përjeton vështirësi dhe ka nevojë për një mbështetje psikologjike

Psikologët dhe psikologët-psikoterapistë mirëpresin personat që kalojnë vështirësi psikologjike. Ata ndërhyjnë për të ruajtur, për të mbështetur ose për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqenien e pacientit, për të zhvilluar aftësitë e tij si dhe për të favorizuar integritimin e tij social. Vendimi për të kryer seanca terapie merret nga terapistët për shumë arsye: nëse pacienti ka çrregullime psikike (fobi, depresion, ankth, etj.), komplekse, ndarje emocionale, burn-out (rraskapitje të organizmit që ndikon në ekuilibrin e tij psikologjik) dhe shumë të tjera. Po ashtu, mund të këshillohen bilance dhe vlerësime psikologjike, si dhe të jepet një mbështetje psikologjike nga një psikolog për vështirësitë specifike që mund të ketë pacienti.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Vështirësitë psikologjike
- Problemet e sjelljes
- Komplekset
- Seksualiteti
- Vajtimi
- Probleme psikike (depresioni, fobitë, ankthi, çrregullimet e të ngrënit etj.)
- Mbështetje prindërve
- Terapi bashkëshortore dhe familjare

ANPP, SHOQATA E PSIKOLOGËVE DHE PSIKOLOGËVE-PSIKOTERAPISTË TË NEUCHÂTEL-IT

- info@anpp.ch
 - <https://www.anpp.ch/>
- Shpenzimet mund të mbulohet nga LAMa1 në kushte të caktuara, zgjeruar që nga viti 2022 për psikologët-psikoterapistë. Informohuni pranë profesionistit që ka lidhje me rastin tuaj.

PSIKIATËRIT DHE PEDOPSIKIATËRIT

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Ndihej i/e dërrmuar që nga lindja e fëmijës tim
- Jam i/e shqetësuar për zhvillimin e fëmijës tim
- Fëmija im ka probleme mendore
- Unë kam çrregullime mendore

Psikiatërit janë mjekët specialistë të shëndetit mendor ndërsa pedopsikiatërit merren veçanërisht me fëmijët. Kur fëmija është i vogël, ai mund të hasë vështirësi në zhvillimin e autonomisë dhe marrëdhënieve me të tjerët si dhe të përjetojë momente krize. Si ta shoqërojmë atë gjatë këtyre fazave? Si të reagojmë nëse ka tensione? Me mbështetjen e ekipeve të njësisë së orientimit të fëmijës, të cilët vëzhgojnë zhvillimin e tij në dimensionet e tij mjekësore, psikologjike, relacionale dhe sociale. Këta specialistë janë të autorizuar të përshkruajnë medikamente nëse është e nevojshme.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Vështirësitë psikike
- Problemet e sjelljes
- Komplekset
- Ankthi
- Fobitë
- Depresioni
- Diagnostikimi
- Mjekimi (përdorimi i medikamenteve për qëllime terapeutike)

LISTA E PSIKIATËRVE NË KANTONIN E NEUCHÂTEL-IT

- <http://www.snm.ch/index.php/component/comprofiler/userslist/36-liste-psychiatrie>
- Mund të mbulohet nga LaMal. Pyesni profesionistin që ka të bëjë me rastin tuaj.

TË TJERA

Ekzistojnë edhe shërbime të tjera në kantonin e Neuchâtel-it që lidhen me tematikën e vështirësive edukative, psikologjike dhe sociale brenda familjes. Një rast i tillë është shërbimi ambulator Ndjekja intensive e Familjes dhe Prindërve, si dhe Udhëzuesi i deleguar prindëror i Kryqit të Kuq Neuchâtel dhe ASAEF (Aksion dhe Mbështetje Ambulatore për Fëmijën dhe Familjen e tij), ofruar nga Fondacioni Carrefour. Këto tre shërbime mbështetëse të familjes janë të disponueshme me këshillën e Zyrës për mbrojtjen e fëmijës. Nëse është e nevojshme, merrni kontakt me këtë zyrë ose pediatrin e fëmijës suaj.

TË GJESH PËRKUJDESJE PËR FËMIJËN DHE NDIHMË PËR DETYRIMET E PËRDITSHME

KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL, SHËRBIMI KUJDESTARI PËR FËMIJËT NË SHTËPI

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është nën 12 vjeç
- Kam një vështirësi kujdestarie të përkohshme
- Fëmija im i është sëmurë dhe duhet të kujdesem për të ose unë jam sëmurë

Shërbimi i Kujdestarisë për fëmijët në Shtëpi vjen në banesë për të ndihmuar familjen në rast se fëmija është i sëmurë, për t'i dhënë mundësi prindit të shkojë në punë ose, në rast se prindi është i paaftë të kujdeset për fëmijën e tij, ose atëherë kur prindi është krejtësisht i padisponueshëm për t'u marrë si zakonisht me fëmijën e tij.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Kujdestari për fëmijët e sëmurë
- Zgjidhje urgjente për kujdestari
- Kujdestari në shtëpi

SHËRBIMI I KUJDESTARISË PËR FËMIJËT NË SHTËPI, KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL

- 032 886 88 65
- ged@croix-rouge-ne.ch
- <https://croix-rouge-ne.ch/services/garde-enfants-a-domicile/>

KRYQI I KUQ NEUCHÂTEL, BABY-SITTING

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Jam në kërkim për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme kujdestarie për fëmijën tim
- Dua të gjej një dado, e cila ka kryer një formacion
- Kam dëshirë të promovoj punën e të rinjve

Falë këtij shërbimi, prindërit e fëmijëve mbi 3 muajsh mund të punësojnë një babysitter (dado) të certifikuar nga Kryqi i Kuq për t'u kujdesur për fëmijën(t) e tyre në shtëpi. Këto dado kanë kryer një formacion teorik të ofruara nga Kryqi i Kuq si dhe një stazh në çerdhe. Prindërve u dërgohet një listë, pasi ata regjistrohen në shërbimin e kujdestarisë së fëmijëve.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Kujdestari për bebet
- Kujdestari për fëmijët e shëndetshëm

SHËRBIMI I KUJDESTARISË PËR BEBET (BABY-SITTING), KRYQI I KUQ ZVICËR

- 032 886 88 60
- contact@croix-rouge-ne.ch
- <https://croix-rouge-ne.ch/services/baby-sitting/>

PRITJE JASHTË FAMILJES

ZYRA PËR STRUKTURAT E PRITJES JASHTË FAMILJES DHE INSTITUCIONET EDUKATIVE TË SPECIALIZUARA (OSAE)

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kërkoj kujdestari për fëmijën tim:
 - Në një strukturë kujdestarie ditore: parashkollore (çerdhe dhe atelie për 0-4 vjeç) ose parashkollore (4-12 vjeç)
 - Tek një prind për kujdestari ditore (nënë ditore)

OSAE mbikëqyr çerdhet, atelietë, kujdestaritë ditore familjare dhe të gjitha format e tjera të kujdestarisë jashtë familjes. Çerdhet janë hapësira komunitare në të cilat kujdestaria për fëmijët bëhet nga një ekip edukativ. Kujdestaria ditore familjare ofron kujdes ditor brenda një familjeje, si një alternativë ndaj çerdheve. Fëmijët janë plotësisht të integruar në jetën familjare dhe prindërit kujdestarë garantojnë sigurinë e tyre. Atelietë janë vende ku fëmijët inkurajohen për të zhvilluar lidhje sociale, shprehje fizike ose kreativitet.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Kujdestari për fëmijët
- Qendra kolektive e kujdestarisë ditore
- Qendra ditore familjare e kujdestarisë
- Lidhjet sociale

OSAE, KONTAKTE PËR QENDRAT E NDRYSHME TË KUJDESTARISË JASHTË FAMILJES

- <https://www.ne.ch/autorites/DEF/SPAJ/ac-cueil-extrafamilial/Pages/parents.aspx>

KUJDESTARI FAMILJARE DITORE

- 032 717 74 53
- <http://www.mamansdejour.ch>

GJENI MBËSHTETJE PËR TË PËRBALLUAR DËSHPËRIMIN

AS'TRAME

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Familja ime po përjeton një humbje ose ndarje
- Një anëtar i familjes sime ose unë po përjeton një sëmundje të rëndë ose një dobësi psikike

As'trame mbështet familjet e prekura nga një humbje, nga një ndarje e prindërve, nga një sëmundje e rëndë ose nga dobësia psikike e një prindi. Ajo ndërhyr pa vonesë në këto familje gjatë situatave që trondisin lidhjen familjare dhe rrezikojnë të rëndojnë mbi të ardhmen e fëmijëve. Ndërhyrja e saj është e kufizuar në kohë dhe bazohet në një pjesëmarrje aktive dhe krijuese. Ajo kujdeset për fëmijët dhe lidhjet e tyre familjare.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Mbështetja
- Shoqërimi
- Vajtimi
- Ndarja e prindërve
- Sëmundja
- Dobësia psikike

AS'TRAME NEUCHÂTEL

Rue Louis-d'Orléans 21
2000 Neuchâtel

- 079 704 90 07
- <https://www.astrame.ch/neuchatel.html>

AGAPA SUISSE-ROMANDE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam përjetuar një abort
- Po kërkoj mbështetje për humbjen

Agapa Suisse-Romande ofron shoqërim dhe mbështetje për personat e prekur nga një humbje perinatale (humbja e fëmijës gjatë shtatzënisë), e që janë të dëshpëruar nga vdekja e një vëllai apo motre përpara lindjes. Një humbje e tillë ndonjëherë ringjall një histori të vështirë jetësore ose shkakton plagë fëmijërie: shoqata ofron gjithashtu mbështetje specifike për njerëzit që përballen me të. Ajo ofron një hapësirë për të folur, mirëpret, dëgjon dhe përpiqet ta kuptojë personin që vuan me ato që ndjen dhe përjeton, duke ofruar, kështu, forma të ndryshme mbështetjeje, si biseda individuale ose në çift, grupe bashkëbiseduese, kafe për zinë perinatale dhe grupe mbështetëse.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- Mbështetja
- Shoqërimi
- Vuajtja perinatale
- Mbijetesa në kontekstin e humbjes së shtatzënisë
- Plagët e fëmijërisë

- 077 521 54 00
- info@agapa-suisseromande.ch
- www.agapa-suisseromande.ch

NOTRE PETITE PARENTHÈSE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Kam përjetuar një humbje të shtatzënisë
- Ne po luftojmë për të pasur një fëmijë
- Kërkoj mbështetje dhe këshilla

Shoqata Notre petite paranthèse ofron grupe diskutimi rreth temave të humbjes perinatale dhe sterilitetit. Ajo ofron me dashamirësi një hapësirë dhe një kohë reflektimi për të dhënë mundësinë që të ndash dhe të shkëmbesh eksperiencia me njerëz të tjerë që përjetojnë të njëjtën përvojë në lidhje me këtë problematikë. Edhe pse nuk janë terapistë, burimet dhe këshillat e tyre janë gjithnjë të vlefshme.

TEMAT QË TRAJTOHEN

- - Grupet e diskutimit
- - Mbështetja
- - Dëgjimi
- - Zija perinatale
- - Dëshira për të pasur fëmijë
- - Steriliteti

- 079 500 74 13
- nopetitepa@gmail.com
- www.notrepetiteparenthese.com

NË RAST URGJENCE

NË RAST URGJENCE, LE 144

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është lënduar ose paraqet vështirësi të rënda fizike të pazakonta
- Fëmija im ka nevojë urgjentisht për përkujdesje

→ Urgjencia: 144

144 është numri i shërbimit të urgjencës dhe ju mundëson të thërrisni një ambulancë. Ai duhet përdorur në rast se duket qartë se fëmija juaj është në rrezik. Numri 144 mund të përdoret për fëmijën tuaj por edhe për të rriturit.

LINJA TELEFONIKE PEDIATRIKE

KY SHËRBIM ËSHTË PËR MUA NËSE, PËR SHEMBULL

- Fëmija im është i sëmurë
- Fëmija im është plagosur lehtë
- Mjeku pediatër nuk është i disponueshëm

LINJA TELEFONIKE PEDIATRIKE

→ 0848 134 134

Linja telefonike pediatrike është numri i urgjencës së specializuar për fëmijët. Ai mund të kontaktohet kur fëmija është i sëmurë ose i lënduar lehtë dhe kur pediatri i fëmijës nuk është i disponueshëm.

NUMRA TË TJERË URGJENCE

SHËRBIM ROJE (MJEK, FARMACIST, DENTIST)

→ 0848 134 134

QENDRA ZVICERANE E INFORMIMIT TOKSIKOLOGJIK

→ 145

ZYRA E MBROJTJES SË FËMIJËVE, EQUIPE DES MONTAGNES

→ 032 889 66 45

ZYRA E MBROJTJES SË FËMIJËVE, EQUIPE LITTORAL EST ET VAL-DE-RUZ

→ 032 889 66 40

ADRESA TË TJERA TË DOBISHME

E DELEGUARA PËR RININË – SPAJ (SHËRBIMI PËR MBROJTJEN E TË RRITURVE DHE TË RINJVE)

Roli i të deleguarës për rininë është që të sensibilizojë dhe të informojë mbi të drejtat e fëmijëve, të mbështesë dhe/ose të orientojë të rinjtë dhe njerëzit që punojnë me ta si dhe të koordinojë shërbimet shtetërore në fushën e aktiviteteve jashtëshkollore të të rinjve.

Ekipi i saj vë në dispozicion, gjithashtu, një katalog të shërbimeve mbështetëse për prindërit dhe për aktivitetet gjatë pushimeve, në adresën www.ne.ch/cataloguefamilles

SOPHIE NEUHAUS,

Fbg de l'Hôpital 36
2000 Neuchâtel

→ 032 889 82 46

→ sophie.neuhaus@ne.ch

→ <https://www.ne.ch/dej>

SANTÉ PSY (PROMOVIMI I SHËNDETIT MENDOR)

SantéPsy.ch është një platformë e kantoneve latine mbi temën e shëndetit mendor. Kjo faqe propozon përmbajtje dhe burime të ndryshme për shumë tema: të jesh prind, rinia, si të kujdeseni për shëndetin tuaj mendor ose, për shembull, si të ndihmoni një të afërm.

→ www.santepsy.ch

L'ÉDUCATION DONNE DE LA FORCE (EDUKIMI TË JEP FORCË) – NEUCHÂTEL

Shoqata Edf-NE është një rrjet profesionistësh, shoqatash dhe institucionesh që punojnë për të mbështetur prindërit në kantonin e Neuchâtel-it. Faqja www.edf-ne.ch është në thelb një katalog i këtyre shërbimeve, të renditura sipas fjalëve kyçe (etiketa) dhe nëpërmjet lidhjeve që i referohen drejtpërdrejt faqeve të tyre.

→ www.edf-ne.ch

KJO BROSHURË ËSHTË REALIZUAR ME INICIATIVËN E

Shërbimit të shëndetit publik

Shërbimi i shëndetit publik është aktiv në fusha të ndryshme të zbatimit të politikës shëndetësore kantonale, veçanërisht në atë të parandalimit të sëmundjeve dhe promovimit të shëndetit. Në këtë kuadër po zhvillohen programe dhe aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me fëmijërinë e hershme.

**SERVICE DE LA SANTÉ PUBLIQUE – ZYRA
E PROMOVIMIT TË SHËNDETIT DHE E
PARANDALIMIT TË SËMUNDJEVE**

Rue des Beaux-Arts 13

2000 Neuchâtel

→ 032 889 52 19

→ SCSP.OPSP@ne.ch

→ www.ne.ch/promotionsante

NË BASHKËPUNIM ME

Zyrën për kujdesin jashtëfamiljar dhe institucionet edukative të specializuara (OSAE)

Misioni i OSAE-së është të autorizojë, të survejojë dhe të këshillojë të gjitha institucionet që kujdesen për fëmijët, në vendbanimin e tyre ose gjatë ditës, ashtu si dhe prindërit kujdestarë ditorë dhe familjet që merren me kujdestari.

OFFICE DE L'ACCUEIL EXTRAFAMILIAL ET DES INSTITUTIONS D'ÉDUCATION SPÉCIALISÉE (OSAE)

M. Marc Dunant, chef d'office
Faubourg de l'Hôpital 23-25
2000 Neuchâtel

→ 032 889 66 34

→ www.ne.ch/accueilextrafamilial

të Deleguarën për rininë

E deleguara për rininë është e ngarkuar të merret me zbatimin e politikës kantonale të rinisë. Roli i saj është të sensibilizojë publikun, veçanërisht të rinjtë, mbi të drejtat e fëmijës dhe të jetë në dispozicion për informacione dhe këshilla.

DÉLÉGUÉE À LA JEUNESSE

M^{me} Sophie Neuhaus
Faubourg de l'Hôpital 36
2000 Neuchâtel

→ 032 889 82 46

→ www.ne.ch/autorites/DEF/SPAJ

SHËNIME

